

Emine HAJDARI

Instituti i Historisë “Ali Hadri”

Email: emine.kalaja@gmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0000-0003-2296-5375>

KUD: 904:930(496.51)(05)

**DËSHMITË EPIGRAFIKE MBI PËRBËRJEN ETNIKE
TË ULPIANËS NË PERIU DHËN ROMAKE****Abstrakt:**

Ky studim shqyrton përbërjen etnike të Ulpianës gjatë shekujve I-IV pas Kr., duke u mbështetur në analizën e mbishkrimeve të dokumentuara në qytet dhe në zonën përreth. Qëllimi është të përcaktohet më qartë fizionomia shumetnike e kësaj qendre provinciale dhe të vlerësohen mënyrat se si proceset e romanizimit dhe integritit administrativ ndikuan në formësimin e saj shoqëror dhe juridik. Të dhënat epigrafike përbëjnë burimin kryesor për rindërtimin e përkatësive individuale dhe kolektive, duke ofruar një pasqyrë të drejtpërdrejtë mbi strukturën e popullsisë urbane. Qasja metodologjike mbështetet në analizën filologjike dhe prosopografike të nomina-ve, cognomina-ve dhe formulave të filiacioneve, si dhe në kontekstualizimin historik dhe arkeologjik të monumenteve epigrafike. Kjo metodë lejon identifikimin e origjinës së individëve, vlerësimin e statusit juridik dhe analizimin e mekanizmave të integritit në jetën publike dhe institucionale të qytetit. Të dhënat onomastike shqyrtohen në raport me sistemin juridik romak, me përhapjen e qytetarisë dhe me ndryshimet në strukturën shoqërore gjatë periudhës së administrimit perandorak. Materiali epigrafik ofron një panoramë të qartë të bashkëjetesës së popullsisë indigjene dardane me kolonë italikë dhe perëndimorë, si edhe me grupe helenofone e orientale, të cilët kontribuuan në mjedisin ekonomik dhe kulturor të Ulpianës. Analiza tregon se adoptimi i elementeve onomastike romake lidhet ngushtë me zgjerimin e qytetarisë dhe me pranimin e normave të sistemit administrativ romak, ndërsa prania e emrave indigjenë dëshmon për vazhdimësinë e traditave lokale brenda strukturave të reja juridike. Ky kombinim ndihmon të shpjegohet edhe mungesa relative e emrave autoktonë në mbishkrime, e cila lidhet më shumë me faktorë socio-ekonomikë, me përkatësinë shoqërore dhe me ritmet e ndryshme të adoptimit të praktikave

funerare romake sesa me praninë reale të tyre në përbërjen e përgjithshme të popullsisë. Epigrafi pasqyron kryesisht shtresat që kishin qasje në kulturën monumentale dhe në mjetet financiare për ngritjen e mbishkrimeve, duke krijuar kështu një përfaqësim selektiv të shoqërisë urbane. Rezultatet tregojnë se Ulpiana zhvilloi një identitet urban të shumëfishtë, ku normat e kulturës romake bashkëjetonin me elemente të qëndrueshme të traditës dardane dhe me prani të dukshme helenofone e orientale. Kjo ndërthurje pasqyron proceset më të gjera të transformimit kulturor në Dardani dhe në provincat ballkanike, si edhe rolin që qendrat urbane patën në integrimin e komuniteteve lokale në strukturat e Perandorisë Romake.

Fjalë kyçe: Ulpianë, struktura etnike, epigrafi, onomastikë, periudha romake, romanizim.

Abstract:

This study examines the ethnic composition of Ulpiana during the 1st–4th centuries AD, relying on the analysis of inscriptions documented in the city and its surrounding area. The aim is to define more clearly the multiethnic character of this provincial center and to assess the ways in which processes of Romanization and administrative integration influenced its social and legal formation. Epigraphic data constitute the primary source for reconstructing individual and collective affiliations, offering a direct insight into the structure of the urban population. The methodological approach is based on the philological and prosopographical analysis of nomina, cognomina, and filiation formulas, as well as on the historical and archaeological contextualization of epigraphic monuments. This method allows for the identification of individuals' origins, the assessment of legal status, and the analysis of the mechanisms of integration into the public and institutional life of the city. Onomastic data are examined in relation to the Roman legal system, the spread of citizenship, and changes in social structure during the period of imperial administration. The epigraphic material offers a clear overview of the coexistence of the indigenous Dardanian population with Italic and Western colonists, as well as with Hellenophone and Oriental groups, who contributed to the economic and cultural environment of Ulpiana. The analysis shows that the adoption of Roman onomastic elements is closely linked to the expansion of citizenship and the acceptance of the norms of the Roman administrative system, while the presence of indigenous names attests to the continuity of

local traditions within the new legal structures. This combination also helps to explain the relative absence of autochthonous names in the inscriptions, which is more closely related to socio-economic factors, social status, and the varying pace of adoption of Roman funerary practices than to their actual presence in the overall population composition. Epigraphy mainly reflects the strata that had access to monumental culture and the financial means to erect inscriptions, thus creating a selective representation of urban society. The results show that Ulpiana developed a multifaceted urban identity, in which the norms of Roman culture coexisted with enduring elements of Dardanian tradition and with a noticeable Hellenophone and Oriental presence. This interweaving reflects the broader processes of cultural transformation in Dardania and in the Balkan provinces, as well as the role that urban centers played in integrating local communities into the structures of the Roman Empire.

Keywords: Ulpiana, ethnic structure, epigraphy, onomastics, Roman period, Romanization.

Dëshmitë epigrafike mbi përbërjen etnike të Ulpianës në periudhën romake

Vendbanimi dardan pararomak, emërtimi i të cilit mbetet ende i paidentifikuar, mbi të cilin u zhvillua më pas Ulpiana, pas pushtimit romak u transformua në një nga qendrat urbane më të rëndësishme të rajonit, duke fituar statusin e municipium-it. Këto zhvillime u mundësuan nga burimet e shumta natyrore që zotëronte Ulpiana dhe prapatoka e saj, veçanërisht në fushën e shfrytëzimit minerar. Integrimi në sistemin romak solli gjithashtu një riformësim të përbërjes etnike. Burimet epigrafike dhe arkeologjike tregojnë se vendbanimi mori një karakter të spikatur shumëtnik, kështu krahas popullsisë autoktone dardane, këtu u vendosën kolonë dhe migrantë nga treva të ndryshme të Perandorisë, përfshirë romakë, trakë, keltë, grekë dhe grupe të tjera të ardhura nga provincat lindore e perëndimore, të cilët lidhen interesat e tyre politike dhe ekonomike me Ulpianën.

Për analizën dhe studimin e përbërjes etnike të Ulpianës gjatë antikitetit, burimet më të çmuara mbeten ato epigrafike, mbi të cilat mbështetet edhe ky studim. Mbishkrimet, të gdhendura në monumente funerare, altarë apo

dedikime të ndryshme me karakter publik, ofrojnë dëshmi të drejtpërdrejta mbi praninë dhe tiparet identitare të individëve që ishin pjesë e jetës politike, kulturore, religjioze dhe ekonomike të këtij qyteti. Ato mundësojnë rindërtimin e strukturës sociale dhe të përkatësive etnike të popullsisë, duke nxjerrë në pah elemente që mungojnë në burime të tjera historike. Analiza e këtij materiali epigrafik lejon gjithashtu identifikimin e grupeve të ndryshme etnike, shpërndarjen e tyre hapësinore, si dhe ndërveprimet kulturore midis popullsisë vendase dhe të ardhurve.

Nga analiza e mbishkrimeve të dokumentuara deri më tani në Ulpianë dhe në një pjesë të arealit të saj,¹ del në pah një mbizotërim i emrave romakë, qoftë me gentilic perandorake apo joperandorake, krahas pranisë së emrave të huaj të individëve të ardhur nga provinca të ndryshme të Perandorisë Romake. Ky material onomastik ofron të dhëna të çmuara jo vetëm për origjinën gjeografike dhe përbërjen etnike të popullsisë, por edhe për shpërndarjen e të drejtës qytetare dhe dallimet në statusin juridik (qytetarë romakë, latinë apo peregrinë), duke pasqyruar kështu proceset e shtresimit shoqëror dhe të transformimeve identitare që kishte njohur qyteti i Ulpianës gjatë antikitetit. Siç vërehet edhe në studimet krahasuese të provincave të tjera të Ballkanit, si në rastin e Dalmacisë,² analiza e *nomina*-ve dhe *cognomina*-ve, veçanërisht në mesin e popullsisë provinciale, është një mjet i rëndësishëm që mundëson të kuptohen më mirë proceset e transformimit kulturor dhe social. Kësisoj, edhe në rastin e Ulpianës, *cognomina*-t, sidomos pas shpalljes së *Constitutio Antoniniana*, pasqyrojnë ndikime të shumanshme kulturore, politike dhe fetare, duke ofruar të dhëna të vlefshme për identifikimin e ndryshimeve në përbërjen etnike, shpërndarjen e të drejtës qytetare dhe modelet identitare të popullsisë. Megjithatë, duhet theksuar se identiteti etnik nuk mund të reduktohet vetëm në emërtim. Një qasje kritike është e domosdoshme, pasi emrat mund të pasqyrojnë strategji integrimi, procese asimilimi kulturore

¹ Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë në kohën romake*, ASHAK, Prishtinë, 1981; Emine Kalaja-Hajdari, *Shndërrimet në Dardani gjatë periudhës romake. Proceset ekonomike, social-politike dhe kulturore*, IHP, Prishtinë, 2017; Arben Hajdari, *Ulpiana et la romanisation de la Dardanie*. Thèse de doctorat, Université Pierre Mendès France, Grenoble 2, 2013; Arben Hajdari & Arianit Buqinca, "A New Unpublished Inscription Dedicated to Jupiter, Discovered in Ulpiana (Kosovo)," *Human and Social Studies* 7, no. 3, 2018, 80-87. <https://doi.org/10.2478/hssr-2018-0026>.

² Jaroslav Šašel, "Contributo alla conoscenza del commercio con gli schiavi norici ed illirici alla fine del periodo repubblicano," in *Atti del III Congresso Internazionale di Epigrafia Greca e Latina*, Roma, 1959, 143.

ose ndryshime të lidhura me statusin juridik, dhe jo domosdoshmërisht të jenë tregues të drejtpërdrejtë të përkatësisë etnike. Për këtë arsye, analiza e tyre kërkon kujdes të shtuar dhe duhet të zhvillohet gjithmonë në raport me kontekstin më të gjerë historik e arkeologjik, duke marrë parasysh kompleksitetin e burimeve dhe të proceseve që ato pasqyrojnë.

Sipas të dhënave të deritanishme nga Ulpiana, emrat e kolonëve romakë të dëshmuar në monumentet epigrafiqe paraqiten dukshëm më të shumtë në numër se sa ata të popullsisë indigjene. Kjo mungesë relative e emrave vendas mund të shpjegohet me disa faktorë të ndërlidhur. Së pari, komunitetet lokale mund të mos e kishin përvetësuar ende traditën romake të ngritjes së monumenteve prej guri, e cila kërkonte mjeshtri të specializuara dhe mbi të gjitha burime financiare të konsiderueshme. Së dyti, pjesa më e madhe e popullsisë indigjene i përkiste shtresave të ulëta ekonomike, kulturore dhe arsimore, të cilat rrallë kishin mundësinë të përfshiheshin në praktikat publike të përkujtimit përmes mbishkrimeve. Së treti, procesi i romanizimit, ndonëse i pranishëm, nuk kishte depërtuar plotësisht në të gjitha aspektet e jetës së tyre shoqërore e kulturore, duke bërë që elementet tradicionale të vazhdonin të mbizotëronin në pjesë të caktuara të komunitetit, sidomos jashtë qendrave urbane.

Në mbishkrimet ku përmenden banorë vendas, jo vetëm në Ulpianë, por edhe në mbarë territorin e Dardanisë, emrat paraqiten zakonisht në formën e një *nomen*-i të shoqëruar nga një patronim i shprehur përmes filiacionit, formulë që korrespondon me modelet onomastike të dëshmuara në Dalmaci.³ Në disa raste, patronimi përdoret si emër vetjak, çka përbën një tipar karakteristik të kësaj zone dhe më shumë gjasë është vazhdimësi e traditave onomastike para romake. Pas integritit në strukturat romake, popullsia vendase iu përshtat normave të reja sociale dhe juridike, duke adoptuar shpesh *gentilic* perandorake, si *Ulpus*, *Aelius* ose *Aurelius*, etj., ndërkohë që ruante emrat tradicionale në formë *cognomen*-i, si në rastin e *Ulpus Andinus*.⁴ Kjo praktikë dëshmon për vazhdimësinë e identitetit lokal brenda kornizës së qytetarisë

³ Duje Rendenić-Miočević 1960, "Ilirske onomastičke studije I", *Živa Antika* 10, Filozofski Fakultet, Skopje, 1960, 163-171.

⁴ Nikola Vulić, "Antički spomenici naše zemlje," *Spomenik SKA* 71, Beograd, 1931, 78, n° 182; Zef Mirdita, *Antroponomija e Dardanisë ...*, 1981, 253, n° 248; Exhlale Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake*, IAP, Prishtinë, 2005, 755-756, n° 203; Emine Kalaja-Hajdari, *Shndërrimet në Dardani ...*, 2017, 312, n° 314. (*D(is) M(anibus) / Ulp(ius) Valentinu(s) / vixit / annis XV / Ulp(ius) Andinus / et Aur(elia) Iulia / parentes filio / pientissimo et / sibi vivis m(erentibus) p(osuerunt)*).

romake dhe për ndërthurjen e elementeve onomastike indigjene me ato të sistemit romak. Në korpusin e emrave të dëshmuar nga mbishkrimet epigrafike të Ulpianës, si banorë me prejardhje vendase mund të identifikohen: *Aelia Nanea*, *Septimius Dassius*, *Annius Timenti*, *Ulpus Andinus*, *Tattia Fidia*, *Sillvae*, *Trita*, *Callia Dasi*, *Vanno*, *Nanae Galli*, *C. Valerius Varanus*, *C. Valerius Marulus* dhe *Udinadius*.⁵ Kësaj liste mund t'i shtohen edhe *Apuleius Numisianus*, *Aelia Celsina*, *Aelia Romana*, *P. Aelius Severinus*, *Maximus Surus*, *Tiberius Claudius Certus*⁶ si dhe dedikues i monumentit të hyut Andin.⁷ Në anën tjetër, *M. Aurelius Valerianus* dhe *Artorius Heraclitus* nuk mund të konsiderohen si vendase, pavarësisht se kishin ngritur dedikime në nderim të kultit të Hyjneshës Dardane.⁸ Në kategorinë e vendasve përfshihen gjithashtu edhe *Apuleius Numisianus*, *Caius Oppius*, *Ulpus Valentinus*, *Aurelia Julia* dhe *Aelius Justus*,⁹ të cilët, megjithëse mbajnë *nomina* latine, ishin me prejardhje vendase dhe kishin fituar të drejtën e qytetarisë romake. Po ashtu, në grupin e vendasve mund të përfshihen edhe individë me origjinë trakase, si *Citanus*, *Sextus Ba...*, *T. Flavius Paetinus*, *Flavi Lyci* dhe *Atta*.¹⁰ Ky segment onomastik përbën një dëshmi të drejtpërdrejtë për përbërjen e larmishme etnike të Ulpianës dhe për ndërthurjen e elementeve indigjenë me ato të traditës romake.

⁵ Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë ...*, 1981, 249, n° 225; Nikola Vulić, *Antički spomenici ...*, *Spomenik* 71, 78, nr. 182; Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë ...*, 25, n° 242; Nikola Vulić, *Antički spomenici ...*, 192, n° 551; A.V. Premerstein & N.Vulić, "Antike Denkmäler in Serbien und Makedonien," *Jahreshefte des Österreichischen Archäologischen Instituts* 6 (1903): Bb. 32, n° 40 ; Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë ...*, 251, n° 235.

⁶ Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë ...*, 1981, 249, n° 225; I njëjti, 25, n° 242; *CIL* III, n° 8184.

⁷ Fatmir Peja, Disa zbulime arkeologjike të periudhës antike në luginën e Llapit, *Trashëgimia etnokulturore dhe historike e Llapit*, Prishtinë, 1995, 70 ; Arben Hajdari, *Ulpiana et la romanisation...*, 2013, 86, nr. 51; Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë ...*, 1981, 254, n° 250; Nikola Vulić, *Antički spomenici ...*, 78, n° 182; I njëjti, 92, n° 551.

⁸ Në lidhje me praktikën e dedikimeve drejtuar Hyjneshës Dardane nga *beneficarii consularis* shih: Arben Hajdari & Christophe J. Goddard. "Le culte de la déesse dardanienne, *dea Dard*(...), au cœur de la diplomatie divine de l'armée romaine" *Mnemosyne* 76, no. 7, 2023, 1198-1215. <https://doi.org/10.1163/1568525x-bja10171>.

⁹ Arben Hajdari, *Ulpiana et la romanisation ...*, 2013.

¹⁰ Nikola Vulić, *Antički spomenici ...*, 77, nr. 179; I njëjti, 192, n° 513; Haxhi Mehmetaj, "Kalorësi në reliev i Ulpianës dhe altari i Vushtrrisë," *Candavia* 3, Tiranë, 2011, 373-381, 373-376, fig. n° 1; *CIL* III, n° 8274.

Analiza onomastike e mbishkrimeve të Ulpianës nuk pasqyron vetëm banorë vendor dhe ndërthurjen e tyre me traditën romake, por edhe praninë e dukshme të kolonëve të ardhur nga Italia dhe provincat e tjera perëndimore të Perandorisë Romake. Këta individë, të dëshmuar në mbishkrime, luajtën një rol të rëndësishëm në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të qytetit. Të dhënat epigrafike, megjithatë, nuk lejojnë të përcaktohet me saktësi as momenti i mbërritjes dhe as origjina e saktë e tyre. Ajo që mund të pohohet mbi bazën e dëshmive epigrafike është se flukset e tyre duket të kenë qenë sporadike dhe të kenë filluar rreth shekullit II pas Kr., në një periudhë kur Ulpiana po përjetonte një zhvillim të fuqishëm ekonomik, të lidhur ngushtë me shfrytëzimin intensiv të pasurive minerare dhe bujqësore. Edhe të dhënat arkeologjike konfirmojnë se pikërisht në këtë periudhë Ulpiana merr fizionominë e një qyteti me tipare të plota romake.¹¹ Prandaj, ardhja e tyre lidhet ngushtë me rritjen dhe zhvillimin e qytetit si një qendër e rëndësishme minerare e rajonit, si dhe me nevojën për një administrim sa më racional të burimeve të tij ekonomike. Në këtë kontekst, burimet epigrafike dëshmojnë praninë e familjeve senatoriale *Furrii* dhe *Pontii*,¹² të cilët gjatë shekujve II-III kishin një rol kyç në administrimin e pasurive të qytetit dhe në menaxhimin e shfrytëzimit të minierave. Ndër kolonët me origjinë të qartë italice konsiderohen *Furia Caecilis*, *Caius Furius Octavianus*, *M. Pontius Varanus Sabinus*, *Antonius Silvanus* dhe *Publius Licinius Aelianus*.¹³ Kësaj liste u shtohen gjithashtu të liruariat dhe skllëverit, të cilët, ndonëse me status juridik dhe social të ndryshëm, përbënin një komponentë të rëndësishme të jetës urbane: *Antonia Victorina*, *Gauri*, *Cornelia Luca*, *Eburiniana*, *Aelia Bona*, *L. Avillius Pudens*, *C. Avillius Pudens*, *Publius N. Severus*, *Varius Crestes*, *L. Titovius Pro...*, *Claudia Rufina*, *Ulpus Rufinus*, *Flavia Chreste*, *M. Cocceius*

¹¹ Arben Hajdari et al., "Premiers résultats des campagnes de fouilles à Ulpiana (2006-2008)." In *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité V: Actes du Ve colloque international de Grenoble (8-11 octobre 2008)*, 445-454. Paris: De Boccard, 2010; Milot Berisha et al., "Ulpiana (Dardanie). La datation de la fortification de l'église septentrionale. Première campagne du programme archéologique franco-kosovar (2017)." *Chronique des activités archéologiques de l'École française de Rome* [Online], Balkans, online since 29 July 2019. Aksesuar me 15 gusht 2025. <https://doi.org/10.4000/cefr.2746>.

¹² Jaroslav Šašel, "Dardania, Furii e Pontii," në *Opera Selecta: Narodna in univerzitetna knjižnica*, Ljubljana, 1992, 152-159.

¹³ A.V. Premerstein & N.Vulić. "Antike Denkmäler ..., 1903, 26, n° 33; *CIL* III, n° 8169; *AE* 1903, 67, n° 284; Të njëjtit, 1903, 29, n° 36; Z. Mirdita. "Eine Inschrift aus Ulpianum" *Zeitschrift für Papyrologie und Epigraphik* 29, 1978, 163.

Viator dhe *Cocceius Ingenuus*.¹⁴ Prania e tyre jo vetëm që pasqyron integrimin e elementeve italice dhe perëndimore në strukturën shoqërore të Ulpianës, por gjithashtu dëshmon për rolin e tyre aktiv në proceset e romanizimit dhe në konsolidimin e identitetit urban të qytetit gjatë periudhës romake.

Një element i veçantë i shumëetnicitetit të Ulpianës është prania e grekëve apo helenofonëve dhe e të ardhurve nga provincat lindore, të cilët, megjithëse rrallë fitonin qytetarinë romake, ishin aktivë në sektorët e tregtisë dhe të minierave. Ndër këta përmenden *Apollonios*, biri i *Menelaos*¹⁵ (frigas), priftërinjtë *Victor Demetrius* dhe *Demetrius Ambibius*,¹⁶ si dhe grekët e romanizuar *M. Aurelius Octavis* dhe *Aelius Octavianus*.¹⁷ Bazuar në *cognomina*, si orientalë ose helenofonë mund të konsiderohen gjithashtu *Marcus Cocceius Eros*, *Asclepiades Septimius*, *Aurelius Asclepiades*, *Ulpus Ionicus*, *Tatta Idati*, *Ablabius* dhe *Alexandria*.¹⁸ Prania e tyre dëshmon për integrimin gradual të qytetarëve me origjinë lindore dhe helenofone në jetën ekonomike, kulturore dhe fetare të Ulpianës, duke shtuar kështu një dimension të rëndësishëm në strukturën shumëetnike të qytetit.

Si përfundim, mbi bazën e të dhënave epigrafike të deritanishme, mund të konstatohet se popullsia e Ulpianës gjatë shekujve I-IV paraqitej me një përbërje heterogjene. Brenda kësaj strukture multi-etnike, rolin kryesor në jetën publike dhe ekonomike të qytetit e mbanin kolonët e ardhur nga Italia dhe provincat perëndimore të Perandorisë, ndonëse ata përbënin një pakicë në raport me popullsinë autoktone. Si qendër e administrimit të minierave dardane dhe e vendosur në një nyje të rëndësishme rrugore që përshkonte

¹⁴ *CIL III*, n° 8274; Nikola Vulić, *Antički spomenici ...*, 77, 1934, 55, n° 54; A.V. Premerstein & N.Vulić. "Antike Denkmäler ...", 1903, 32, n° 39; *CIL III*, n° 8179; *CIL III* n° 8177; Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë ...*, 1981, 249, n° 222; Arthur, J. Evans, *Antiquarian Researches in Illyricum. Part III-IV, Archaeologia* 49, Westminster, 1885, 60; Nikola Vulić, *Antički spomenici ...*, 42, n° 98; A.V. Premerstein & N.Vulić. "Antike Denkmäler ...", 1903, 35, n° 42.

¹⁵ *L'Année Épigraphique*, 1972, 144, n° 502.

¹⁶ Nikola Vulić, *Antički spomenici ...*, 192, n° 510.

¹⁷ Fatmir Peja, "Epigrafski Spomenici," *Arheolosko Blago*, Beograd, 1998, 652, n° 307; Emil Čerškov, *Rimljani na Kosovu i Metohiji*, Arheološko društvo Jugoslavije, Beograd, 1969, 65.

¹⁸ A.V. Premerstein & N.Vulić. "Antike Denkmäler ...", 1903, 31 n° 37; Edi Shukriu, "Dea e Dardanisë dhe monumentet tjera epigrafike nga Smira," *Buletini i Fakultetit Filozofik* 26, 1999, 27; Maja Parović-Pešikan, "Novi spomenik Jupitera Melana iz Ulpiani," *Arheološki vestnik* 41, 1990, 607; *CIL III* n° 8180 (1695); *CIL III* n° 8177; Zef Mirdita, "O jednoj arii iz centralnog područja Dardanije," *Arheološki vestnik* 38, 1987, 363-368, fig. 2; I njëjti, "Novitates Epigraphicae e Dardania Collectae," *Arheološki vestnik* 31, 1980, 190, n° 9.

Dardaninë, Ulpiana paraqitet si një qytet veçanërisht tërheqës dhe me përfitime të konsiderueshme ekonomike për kolonët e ndryshëm romakë. Ky diversitet etnik dhe prania e kolonëve nga pjesë të ndryshme të Perandorisë përbënin një faktor kyç në procesin e romanizimit të qytetit dhe të rajonit përreth.

Të dhënat onomastike nga mbishkrimet e zbuluara në Ulpianë dëshmojnë për një përbërje të larmishme etnike të popullsisë, tipar karakteristik për një qytet provincial të integruar në sistemin administrativ dhe kulturor romak. Pjesa më e madhe e individëve të përmendur në monumente mbajnë *nomina* të tipit romak si *Ulpus*, *Aelius*, *Aurelius*, *Flavius*, *Valerius*, *Licinius*, *Pontius* etj., të cilat nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht përkatësinë etnike, por më tepër përvetësimin e statusit qytetar dhe të kulturës latine, veçanërisht pas shpalljes së *Constitutio Antoniniana*. Krahas tyre, dokumentohen edhe emra me formë të pazakontë ose jo latine siç e kemi rastin me emrat si: *Tattia*, *Atta*, *Utinadius*, *Surus*, *Gauri*, *Vanno*, *Trita*, *Callia Dasi*, *Nanae Galli*, *Lyci*, të cilët mund t'u atribuohen individëve me prejardhje dardane ose grupeve të romanizuara vetëm pjesërisht. Këta persona shfaqen shpesh në lidhje familjare me qytetarë të romanizuar, duke dëshmuar procese të integritit të brendshëm dhe të ndërthurjes kulturore.

Po ashtu, mbishkrimet dëshmojnë për praninë e elementit helenofon dhe oriental, të identifikuar përmes emrave si *Apollonios*, *Demetrius*, *Victor*, *Asclepiades*, *Eros*, *Ablabius*, *Ionicus* dhe *Alexandria*, tipikë për provincat lindore të Perandorisë. Disa prej tyre, si *M. Aurelius Octavius* dhe *Aelius Octavianus*, i përkasin shtresës së qytetarëve të romanizuar me origjinë nga provincat greke. Prania e këtyre grupeve, të lidhur me strukturat administrative, ekonomike dhe fetare, sugjeron ndërveprime të shumanshme kulturore, ndërsa onomastika e tyre pasqyron procese të romanizimit formal mbi baza kulturore heterogjene.

Është me rëndësi të theksohet se një pjesë e konsiderueshme e individëve që paraqiten si bartës të emrave romakë i përkisnin kategorisë së skllëvërve të liruar, si në rastet e *Antonia Victorina*, *Claudia Rufina*, *Flavia Chreste*, *Cornelia Luca*, *Aelia Bona*, *Eburiniana*, *Ulpus Rufinus*, *Cocceius Ingenus* e të tjerë. Kjo tregon se mbishkrimet janë ruajtur kryesisht nga shtresat urbane me status të përmirësuar, të cilat kishin mundësinë të linin gjurmë në kulturën materiale përmes monumenteve funerare ose dedikimeve kushtuar hyjnive të ndryshëm. Në tërësinë e tyre, emrat e dëshmuar në mbishkrimet e Ulpianës nuk ofrojnë vetëm një panoramë të përbërjes etnike, por edhe një pasqyrë të transformimeve sociale, juridike dhe kulturore që kjo qendër dardane përjetoi

nën ndikimin dhe administrimin e strukturave të Perandorisë Romake. Ata pasqyrojnë ekzistencën e një shoqërie të përbërë nga qytetarë romakë, provincialë të romanizuar, vendas të integruar pjesërisht në sistemin romak, të liruar, si dhe bartës të kulturës greko-orientale, duke e vendosur Ulpianën në kuadrin e një qyteti multietnik dhe kozmopolitan të kohës.

Përfundime

Si përfundim, mbi bazën e të dhënave epigrafike të deritanishme, mund të konstatohet se popullsia e Ulpianës gjatë shekujve I-IV paraqitej me një përbërje heterogjene. Brenda kësaj strukture multietnike, rolin kryesor në jetën publike dhe ekonomike të qytetit e mbanin kolonët e ardhur nga Italia dhe provincat perëndimore të Perandorisë, ndonëse ata përbënin një pakicë në raport me popullsinë autoktone. Si qendër e administrimit të minierave dardane dhe e vendosur në një nyje të rëndësishme rrugore që përshkonte Dardaninë, Ulpiana paraqitej si një qytet veçanërisht tërheqës dhe me përfitime të konsiderueshme ekonomike për kolonët e ndryshëm romakë. Ky diversitet etnik dhe prania e kolonëve nga pjesë të ndryshme të Perandorisë përbënin një faktor kyç në procesin e romanizimit të qytetit dhe të rajonit përreth.

Të dhënat onomastike nga mbishkrimet e zbuluara në Ulpianë dëshmojnë për një përbërje të larmishme etnike të popullsisë, tipar karakteristik për një qytet provincial të integruar në sistemin administrativ dhe kulturor romak. Pjesa më e madhe e individëve të përmendur në monumente mbajnë *nomina* të tipit romak si *Ulpus*, *Aelius*, *Aurelius*, *Flavius*, *Valerius*, *Licinius*, *Pontius* etj., të cilat nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht përkatësinë etnike, por më tepër përvetësimin e statusit qytetar dhe të kulturës latine, veçanërisht pas shpalljes së *Constitutio Antoniniana*. Krahas tyre, dokumentohen edhe emra me formë të pazakontë ose jo latine siç e kemi rastin me emrat si: *Tattia*, *Atta*, *Utinadius*, *Surus*, *Gauri*, *Vanno*, *Trita*, *Callia Dasi*, *Nanae Galli*, *Lyci*, të cilët mund t'u atribuohen individëve me prejardhje dardane ose grupeve të romanizuara vetëm pjesërisht. Këta persona shfaqen shpesh në lidhje familjare me qytetarë të romanizuar, duke dëshmuar procese të integritit të brendshëm dhe të ndërthurjes kulturore.

Po ashtu, mbishkrimet dëshmojnë për praninë e elementit helenofon dhe oriental, të identifikuar përmes emrave si *Apollonios*, *Demetrius*, *Victor*, *Asclepiades*, *Eros*, *Ablabius*, *Ionicus* dhe *Alexandria*, tipikë për provincat lindore të Perandorisë. Disa prej tyre, si *M. Aurelius Octavius* dhe *Aelius*

Octavianus, i përkasin shtresës së qytetarëve të romanizuar me origjinë nga provincat greke.

Prania e këtyre grupeve, të lidhur me strukturat administrative, ekonomike dhe fetare, sugjeron ndërveprime të shumanshme kulturore, ndërsa onomastika e tyre pasqyron procese të romanizimit formal mbi baza kulturore heterogjene.

Është me rëndësi të theksohet se një pjesë e konsiderueshme e individëve që paraqiten si bartës të emrave romakë i përkisnin kategorisë së skllëvërve të liruar, si në rastet e *Antonia Victorina*, *Claudia Rufina*, *Flavia Chreste*, *Cornelia Luca*, *Aelia Bona*, *Eburiniana*, *Ulpus Rufinus*, *Cocceius Ingenius* e të tjerë. Kjo tregon se mbishkrimet janë ruajtur kryesisht nga shtresat urbane me status të përmirësuar, të cilat kishin mundësinë të linin gjurmë në kulturën materiale përmes monumenteve funerare ose dedikimeve kushtuar hyjnive të ndryshëm.

Në tërësinë e tyre, emrat e dëshmuar në mbishkrimet e Ulpianës nuk ofrojnë vetëm një panoramë të përbërjes etnike, por edhe një pasqyrë të transformimeve sociale, juridike dhe kulturore që kjo qendër dardane përjetoi nën ndikimin dhe administrimin e strukturave të Perandorisë Romake. Ata pasqyrojnë ekzistencën e një shoqërie të përbërë nga qytetarë romakë, provincialë të romanizuar, vendas të integruar pjesërisht në sistemin romak, të liruar, si dhe bartës të kulturës greko-orientale, duke e vendosur Ulpianën në kuadrin e një qyteti multietnik dhe kozmopolitan të kohës.

Bibliografi:

Korpuse epigrafike:

- AE (*L'Année Épigraphique*). 1972. No. 502.
- CIL (*Corpus Inscriptionum Latinarum*). Vol. III. Berlin: Reimer, nos. 8169, 8177, 8179, 8180, 8184, 8274.

Monografi:

- Čerškov, Emil. *Rimljani na Kosovu i Metohiji*. Beograd: Arheološko društvo Jugoslavije, 1969.
- Dobruna-Salihi, Exhlale. *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2005.
- Evans, Arthur J. *Antiquarian Researches in Illyricum*, Parts III-IV. *Archaeologia* 49, Westminster: Nichols & Sons, London, 1883-1885.
- Hajdari, Arben. *Ulpiana et la romanisation de la Dardanie*. PhD diss., Université Pierre Mendès-France, Grenoble 2, 2013.
- Kalaja-Hajdari, Emine. *Shndërrimet në Dardani gjatë periudhës romake: Proceset ekonomike, social-politike dhe kulturore*. Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2017.
- Mirdita, Zef. *Antroponimia e Dardanisë në kohën romake*. Prishtinë: ASHAK, 1981.

Punime shkencore:

- Berisha, Milot, et al. “Ulpiana (Dardanie): La datation de la fortification de l'église septentrionale. Première campagne du programme archéologique franco-kosovar (2017).” *Chronique des activités archéologiques de l'École française de Rome, Balkans*, posted July 29, 2019. <https://doi.org/10.4000/cefr.2746>.
- Goddard, Christophe J., and Arben Hajdari. “Le culte de la déesse dardanienne, dea Dard (...), au cœur de la diplomatie divine de l'armée romaine.” *Mnemosyne* 76, no. 7 (2023): 1198-1215. <https://doi.org/10.1163/1568525x-bja10171>.
- Hajdari, Arben, and Arianit Buqinca. “A New Unpublished Inscription Dedicated to Jupiter, Discovered in Ulpiana (Kosovo).” *Human and Social Studies* 7, no. 3 (2018): 80-87. <https://doi.org/10.2478/hssr-2018-0026>.
- Hajdari, Arben, et al. “Premiers résultats des campagnes de fouilles à Ulpiana (2006-2008).” In *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité V*, 445-454. Paris: De Boccard, 2010.

-
- Mehmetaj, Haxhi. “Kolorësi në relief i Ulpianës dhe altari i Vushtrrisë.” *Candavia* 3 Tiranë, (2011): 373-381.
- Mirdita, Zef. “Eine Inschrift aus Ulpianum.” *Zeitschrift für Papyrologie und Epigraphik* 29 (1978): 163.
- Mirdita, Zef. “Novitates Epigraphicae e Dardania Collectae.” *Arheološki vestnik* 31 (1980): 185-200.
- Parović-Pešikan, Maja. “Novi spomenik Jupitera Melana iz Ulpiani.” *Arheološki vestnik* 41 (1990): 607-615.
- Peja, Fatmir. “Disa zbulime arkeologjike të periudhës antike në luginën e Llapit.” In *Trashëgimia etnokulturore dhe historike e Llapit*, 68-80. Prishtinë, 1995.
- Peja, Fatmir. “Epigrafski spomenici.” In *Arheološko blago*, 640-660. Beograd, 1998.
- Premerstein, A., and Nikola Vulić. “Antike Denkmäler in Serbien und Makedonien.” *Jahreshefte des Österreichischen Archäologischen Instituts* 6 (1903): 1-96.
- Rendenić-Miočević, Duje. “Ilirske onomastičke studije I.” *Živa Antika* 10 (1960): 163-171.
- Šašel, Jaroslav. “Contributo alla conoscenza del commercio con gli schiavi norici ed illirici alla fine del periodo repubblicano.” In *Atti del III Congresso Internazionale di Epigrafia Greca e Latina*, 143-152. Roma, 1959.
- Šašel, Jaroslav. “Dardania, Furi e Pontii.” In *Opera Selecta*, 152-159. Ljubljana: Narodna in univerzitetna knjižnica, 1992.
- Shukriu, Edi. “Dea e Dardanisë dhe monumentet tjera epigrafike nga Smira.” *Buletini i Fakultetit Filozofik* 26, Prishtinë, (1999): 19-33.
- Vulić, Nikola. *Antički spomenici naše zemlje*. Spomenik SKA 71. Beograd: SKA, 1931.
- Vulić, Nikola. *Antički spomenici naše zemlje*, suppl. Beograd: SKA, 1934.

Emine HAJDARI

The Institute of History “Ali Hadri”

Email: emine.kalaja@gmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0000-0003-2296-5375>

KUD: 904:930(496.51)(05)

SUMMARY**EPIGRAPHIC EVIDENCE ON THE ETHNIC COMPOSITION
OF ULPIANA IN THE ROMAN PERIOD**

Epigraphic evidence from Ulpiana during the Roman period provides a clear insight into its multiethnic composition and the processes of Romanization that accompanied the city's development. In this pre-Roman Dardanian settlement, which was transformed into a *municipium* following the Roman conquest, inscriptions attest to the presence of the local population alongside colonists arriving from Italy, from the western and eastern provinces, as well as from Hellenophone and Oriental communities. This ethnic diversity is clearly reflected in the onomastic material. Although Roman *nomina* are more frequent, the presence of non-Latin names indicates the continuity of local traditions and their partial integration into the cultural and legal framework of the Empire. Romanized locals often retained traditional *cognomina*, combining elements of local identity with Roman naming conventions. At the same time, Italic colonists and Roman freedmen, widely attested in the epigraphic record, played an important role in the economic and administrative life of the city.

Within this mosaic, the Hellenophone and Oriental element is also evident, identifiable through characteristic Greek and Eastern names. The involvement of these groups in trade, mining industries, and cultic functions indicates Ulpiana's connections with the eastern provinces and the emergence of new layers of identity within the city. Overall, the inscriptions from Ulpiana present the city as a typical provincial center of the Roman world, where cultural interaction, gradual Romanization, and social and economic mobility played a continuous role in shaping urban life. In this context, the onomastic data not only reveal the city's diverse ethnic composition but also reflect broader social, legal, and cultural changes that accompanied Ulpiana from the first to the fourth century CE.